

21, 02, 2024

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA

KOMUNA E PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grupi i Operatoreve Ekonomik: "ORG Urbanism&Architecture" & "Rafi Segal Architecture Urbanism LLC & "O.U.D. Architects", adresa: Molenbeek-Saint – Jean, Belgium, me numër të regjistrimit të biznesit 891233624 (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Konkurs projektimi - Art&teknology Hub - Tulltorja - me numër identifikues:616-23-8833-4-1-3

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është përfundimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për:

Konkurs projektimi - Art&teknology Hub – Tulltorja në harmoni me kërkesat estetike dhe kërkesat tjera të Autoritetit Kontraktues, sipas specifikimeve teknike dhe detyrave projektuese që janë pjesë e kësaj kontrate. Autoriteti kontraktues gëzon të drejtën që gjatë hartimit të projektit zbatues të bëjë modifikim të zgjedhjes ideore përmes personave të autorizuar nga ana e Autoritetit kontraktues deri në një masë që nuk ndikon substancialisht nga zgjedhja e ofruar.

1.2 Vendi i pranimit të shërbimeve përkatësisht projektit do të jetë Autoriteti Kontraktues përmes personave të autorizuar profesional dhe ti përmbaj të gjitha të dhënat e nevojshme e të kërkuara sipas detyrave projektuese nga Autoriteti Kontraktues. Periudha e për dorëzimin e projektit zbatues është maksimum 180 ditë nga dita e caktuar në planin e menaxhimit të kontratës.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve për hartimin e projektit zbatues duhet të jetë: **1,200,000.00 €; (Një milion e dyqind mijë Euro e zero eurocent).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Autoriteti kontraktues do të paguaj kontraktuesit vlerën e punimit të projektit pas përfundimit dhe dorëzimit të tij tek Autoriteti Kontraktues si dhe konstatimit nga personat e autorizuar se projektet janë sipas kërkesave dhe detyrave projektuese të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4**Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues		Për kontraktuesin	
Emri:	Visar Shehu	Perparim Rama	PERPARIM RAMA
Pozita:	UD i Udhëheqësit të Prokurimit	Kryetar	ODHJARRI ANASTOR
Nënshkrimi:			
Data:	21.02.2024		21.02.2024
Vula:			



PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve sigurvekse të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur sigurveksi e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënie e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një date tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrin me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospective dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për

ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndër marrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafte të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendrike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigojnë.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asemi te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Kontraktuesi	1.3	Grup i Operatorëve Ekonomik: " ORG Urbanism & Architecture BV " & " Rafi Segal Architecture Urbanism LLC " & " OUD +Architects ", kanë bërë marrëveshje partneriteti për përfundimin e shërbimeve për projektin: Konkurs projektimi - Art&teknology Hub - Tulltorja . Sipas marrëveshjes lider i kësaj kontrate është " ORG Urbanism & Architecture BV " Shpk nga Belgjika dhe se personi përgjegjës për nënshkrimin e kësaj kontrate është Bekim Ramku .
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e fillimit të Shërbimeve është <i>data e nënshkrimit të kontratës</i> .
	6.4	Data e Përfundimit është 9 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës .
	6.5	<i>Vendi i kryerjes së shërbimeve është në Prishtinë.</i>
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11.1	Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes dhe efikasitet në përputhje me praktikatat më të mira profesionale. Ofruesi i shërbimeve me kërkesën e AK do të bëjë mbikëqyrjen e punimeve nga hartuesi i projektit kryesor pa ndonjë kosto financiare shtese.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim të ZKA
Dëmet likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% e çmimit final të kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në afat prej 300 ditëve

Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Autoriteti kontraktues do të paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione. Situacionet paguhen mvarësisht prej dorëzimit të projektit në fazën të cilat faza do të parashihen në planin e menaxhimit me konstatim nga menaxheri dhe mbikëqyrësit e projektit.
	16.2	Llogaria bankare në të cilën do të bëhet transferimi i mjeteve bazuar në konstatimet e menaxherit dhe mbikëqyrësit të kontratës është llogaria e anëtarit të konzorciumit : OUD + Architects, me adresë në Ulpianë, rruga Hakif Zejnullahu S11 ¼ Prishtinë. Nymri i llogarisë (IBAN): XK05 1110 0039 8700 0103
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Inspektimi bëhet nga menaxheri i projektit si dhe personat tjerë që do të autorizohen nga Autoriteti Kontraktues
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E PRISHTINËS, të zytareve përgjegjës të Autoriteteve Kontraktuese që shfrytëzojnë kontratën dhe personat përgjegjës të OE.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedurë gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën komerciale -në Prishtinë.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME

Detyrat projektuese për hartimin e projektit ideor urb-aktitektonik

“ARTECH Center – Tulltorja”

PËRMBAJTJA

1. Hyrje
2. Të dhënat e përgjithshme për Projektin
3. Zgjidhja urbane
4. Detyra projektuese
5. Kriteret vlerësuese
6. Vlerësimet

3.PREDISPOZITAT URBANISTIKE

Lokacioni gjindet në pjesën veriperëndimore të qytetit. Kjo zonë periferike në kohën e ndërtimit të Fabrikës së Tullave, me zhvillimet e hovshme të qyteti dekadave të fundit, është e rrethuar nga tri lagjet më të mëdha të banimit, Tophane, Arbëri dhe Kodra e Trimave, dhe sot është vetëm 10 minuta larg sheshit qendror të kryeqytetit. Si e tillë ajo paraqet potencial të jashtëzakonshëm që të shëndërrohet në një pikë publike ndërlidhëse në mes lagjeve të banimit dhe pjesës administrative dhe kulturore. Ky konkurs ka për qëllim që potenciali i këtij lokacioni të mos përdoret vetëm për ofrimin e hapësirave në shërbim bukfat të artit dhe teknologjisë, por njëkohësisht në një pikë referente të hapësirave publike që do të bënte ndërlidhjen e këtyre tri lagjeve me pjesën qendrore të qytetit, e që për momentin i ndanë rruga qëçon në drejtim të Podujevës si dhe hekurudha (tani për tani jofunksionale) Prishtinë – Nish.



Fig
2.




Fig 3



Fig.
4




Fig 7




Fig
8.

REZULTATET E PRITURA NGA KY PROJEKT JANË:

Ky tender i hapur është duke u ekzekutuar për të emëruar një konsorcium multidisiplinar për të punuar me Komunën e Prishtinës për të realizuar një plan vizioniurban të Distriktit Art Tech në Prishtinë.

Plani i vizionit urban duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

Plani masiv arkitektonik urban për të gjithë kantierin i cili përmban restaurimin e strukturave ekzistuese si dhe projektimin e strukturave të reja dhe hapësirës së hapur publike.

Identifikoni, parashikoni dhe përshkruani mundësitë për sipërmarrje krijuese, bashkëpunime midis industrive të artit dhe teknologjisë, prodhimit artistik dhe prezantimit dhe/ose ekspozimit të formave dhe zhanreve të ndryshme të artit Skematizoni dhe parashikoni nevojat teknike, elektrike dhe dixhitale të qiramarrësve të ndryshëm

Përcaktoni transportin dhe aksesin e këmbësorëve dhe angazhimin e përdoruesve brenda dhe përmes saj

Citoni precedentë ndërkombëtarë, bashkëkohorë për aspekte të ndryshme të planit të vizionit

Përvijoni aspektet financiare dhe teknike

Përshkruani metodologjinë e zbatimit

Rigjallërimi përmes qasjeve bashkohore rikonstruese – adaptuese – interpoluese i një prej lokacioneve të jashtëzakonshëm tek ish Fabrika e Tullave.

Krijimi i një artit dhe teknologjisë me standardet më të larta bashkëkohore.

Krijimi i një hapësireje publike përreth ndërtesave ekzistuese dhe atyre që do të interpelohen si pikë referente artistike dhe ndërlidhëse në mes lagjeve Topane – Arbëri – Kodrea e trimave dhe pjesës qendërore të kryeqytetit.

Furnizuesi do të sigurojë tarifën për planin e vizionit urban dhe ndarjen e tarifës brenda ekipit, fazat e punës, kohëzgjatjen e secilës fazë dhe përshkrimin e shkurtër të qasjes dhe një plan vizioni urban i cili do të përfshijë:

- Analiza urbane e aktivitetit në kantier dhe studime precedente
- Studim social dhe analizë kontekstuale e lokacionit dhe lagjes përreth
- Skicë programore për të ushqyer/ nxitur dhe paraqitur punën e artistëve të ndryshëm
- Studime programore dhe përdorim të tokës për pjesë të ndryshme të planit dhe ndërtesave
- Studim ekonomik dhe financiar për modelet e pronësisë/leasing
- Zhvillimi i një plani që përfshin dhe merr parasysh sa vijon:
 - o Konteksti urban në zhvillimin e ardhshëm
 - o Vlerësimi i gjendjes aktuale të ndërtesave individuale
 - o Identifikoni aspektet e rinovimit, restaurimit dhe ndërtimeve të reja
 - o Udhëzime për zhvillimin e ardhshëm të ndërtesave individuale
 - o Infrastruktura
 - o Transporti
 - o Peizazhi

Kërkesat e projektit

- Dorëzimi i projekteve do të jetë në formë dixhitale për kërkesat e qytetit.

- Aplikantët duhet të kenë parasysh aspektet e mëposhtme të projektit:

1. Identiteti lokal

1.1. Një propozim i artikuluar urban dhe arkitektonik i lidhur drejtpërdrejt me nevojat sociale dhe përpjekjen për identitet lokal.

1.2. Propozimi i një rrjeti zgjidhjesh shumë kontekstuale për atë se çfarë mund të jetë një zonë e teknologjisë së artit.

1.3. Përgjigja arkitekturore ndaj një gjendjeje unike kulturore.

2. Aspekte sociale

2.1 Baza sociale e rrethit do të jetë një rrjet lidhjesh të shumëllojshme, të cilat duhet të akomodohen dhe bëhen të mundura nëpërmjet projektimit, planifikimit dhe përdorimit të hapësirës si në shkallë urbane ashtu edhe në atë të ndërtimit. Kjo kërkon një theks në distriktin e artit që funksionon si një terren takimi për palët e interesuara lokale dhe globale.

3. Konteksti dhe Vizioni Urban

3.1. Duke eksploruar avantazhet e madhësisë, rrethi duhet të konceptohet si një segment i qytetit të hiper-lidhur.

3.2. Prodhimi i një fragmenti urban do të sigurojë ekzistencën e distriktit si një qytet-sistem i përfshirë me strukturën e Prishtinës dhe jo si një kampus i mbyllur, steril që i reziston qytetit.

3.3. Vizioni urban i rrethit mbështetet në një mjedis të lundrueshëm me përdorime të përziera, një orar të dendur urban të përditshëm dhe një strukturë të gjallë që vepron si një katalizator për jetën e qytetit me intensitet të lartë dhe me cilësi të lartë.

3.4. Ndërsa rrjetet e reja infrastrukturore po propozohen, një strategji për të ardhmen e tyre si dhe të ardhmen e lidhjes rajonale.

4. Aksesueshmëria

4.1. Qasja dhe lëvizja në të gjithë rrethin duhet të marrë parasysh të gjitha mënyrat e lëvizjes - të pavarura, të motorizuara dhe të asistuar. Qëllimi është të prodhohet një hapësirë shumë e aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse me një liri demokratike të lëvizjes për të gjithë.

5. Programi

5.1. Një aplikim programesh dhe përdorimesh si platformë për rritje dhe zhvillim në të ardhmen.

6. Llojet e ndërtesave

6.1. Projekti promovon një eksplorim të ri tipologjik, duke prodhuar variacione arkitekturore që reagojnë ndaj nevojës, shkallës, rëndësisë kulturore dhe vendndodhjes.

6.2. Një shumëllojshmëri parcelash dhe pozicionesh do të sigurojnë një rrjet të larmishëm mundësish arkitekturore si për zhvilluesit ashtu edhe për banorët, si dhe do të mbrojnë identitetin lokal nga grackat e hapësirave monotone.

6.3. Një propozim strategjik për ndërtimin e të drejtave dhe mekanizmat e zhvillimit

7. Peizazhi

7.1. Rrethi do të funksionojë si pjesë e një tërësie më të madhe, me ndërgjegjësim ndaj peizazhit përreth. Të gjitha propozimet duhet të marrin parasysh kontekstin e qarkut, duke e gërshetuar atë brenda qytetit dhe duke pasur një kufi të hapur me të.

7.2. Një theks duhet vënë në mënyrat e shumta në të cilat rrethi 'prek' dhe lidhet me qytetin.

8. Fazimi

8.1. Propozimi duhet të hartojë një strategji të fazave, ku çdo fazë strukturore të veprojë si një shtet urban plotësisht i funksionueshëm, duke lejuar akumulimin e fazave në një tërësi urbane.

8.2. Projekti nuk përfshihet thjesht në zgjidhjet e çështjeve aktuale. Përkundrazi, është një platformë për të menduar për të ardhmen. Propozimet duhet të jenë pjesë e një vizioni të së ardhmes dhe duhet, në vetvete, të nisin imagjinata të reja për Prishtinën.

Afati kohor i projektit

Afati fillestar: 6 muaj

Fazat e projektit

Projekti do të përfshijë fazat e mëposhtme:

1. Përzgjedhja e fituesit (çmimi i parë i cili fiton të drejtën e hartimit të projektit zbatues me të gjitha fazat) dhe dy çmimeve të tjera të cilët do të shpërblehen me vlera monetare (Çmimi i dytë 60.000,00 euro. Çmimi i tretë 40.000,00 euro).

AFATI: 3 MUAJ NGA DITA E SHPALLJES SË KËTIJ PROKURIMI.

2. Hartimi i projektit kryesor nga ana e fituesit të çmimit të parë me të gjitha fazat e mëposhtme:

- 2.1. Projekti zbatues arkitektonik
- 2.2. Analiza statike e ndërtesave ekzistuese
- 2.3. Logaritjet statike dhe detajet e armimit ose të konstruksionit metalik/drurit nëse ka të tilla në projekt.
- 2.4. Projekti zbatues i instalimeve elektrike
- 2.5. Projekti zbatues i instalimeve makinerike (ngrohje/ftohje, ventilim, etj.)
- 2.6. Projekti zbatues i instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit
- 2.7. Projekti i analizës akustike të hapësirave specifike për performim
- 2.8. Projekti i analizës së ndriçimit në hapësirat specifike për ekspozim
- 2.9. Projekti zbatues i trajtimit të pejsazhit
- 2.10. Elaborati gjeomakanik.
- 2.11. Elaborati i ndikimit në mjedis
- 2.12. Elaborati i ndikimit në trafik
- 2.13. Elaborati kundërzjarrit
- 2.14. Analizë të detajuar financiar për të gjitha fazat e investimit

Afati: 6 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës me fituesin e çmimit të parë, përhartimin e Projektit Zbatues.

PËRMBAJTJA E PROJEKTIT

Konkurrentët brenda afatit të paraparë me konkurs duhet të dorëzojnë projektin ideor urb-arkitektonik sipas kërkesave të specifikuara në vijim:

- Përmbledhjen dhe përshkrimin e konceptit dhe dizajnit të propozuar, me tekst dhe vizualizime në formë të broshurës në dy (2) kopje fizike në formatin A3;
 - ideja kryesore dhe parimet udhëzuese të dizajnit;
 - integrimi në aspektin e dizajnit urban, përfshirë hapësirat e jashtme;
 - koncepti hapësinor (cilësitë e hapësirave të brendshme, qarkullimi, ndriçimi);
 - integrimi në aspektin e arkitekturës së peizazhit;
 - prezentimi grafik i projektit (situacionet, bazat, prerjet, fasadat, 3D)
- Pjesën grafike të projektit ideor urb-arkitektonik në formë digjitale në formatin A0 të ruajtur në PDF;
Pjesa grafike do duhet të përmbajë:
 - Përshkrimi i konceptit të idesë së dizajnit (prezentim sipas dëshirës)
 - Paraqitja e marrëdhënieve të kompleksit me elemente urbane të zonës, shkalla 1:1000;
 - Paraqitja e mjedisit urban, shkalla 1: 500, e orientuar nga veriu, duke treguar:
 - kompleksi/strukturat e reja të propozuara
 - pamja e sipërme e strukturës
 - numrat e kateve
 - hyrjet e ndërtesës (shigjeta)
 - qasja në trafik
 - Plani i katit përdhësë, shkalla 1: 500, e orientuar nga veriu, duke përfshirë edhe zgjidhjen urbane të situacionit të ngushtë;
 - Planimetritë e të gjitha kateve dhe zgjidhjen funksionale në shkallë 1:200;
 - Prerjet karakteristike në shkallë 1:200, minimum 4 prerje;
 - Fasadat në shkallë 1:200, duke përfshirë edhe specifikimin e materialeve;
 - Perspektivat karakteristike të ndërtesës, eksterier dhe enterier;
- Katër (4) Pano të formatit A1 për ekspozitë të hapur për qytetarët;
- Kostoja e përafërt e investimit e ndarë në dy faza:
 - Preventivi (aprox. BoQ) për renovim të Stacionit qendror të autobusëve
 - Preventivi (aprox. BoQ) për ndërtim të sallës së sporteve
- Çdo punim për konkurs duhet të përmbajë maketën në përpjesë 1:250, e cila do të paraqes tërësinë e kompleksit. Si shtesë e dokumentacionit, mund të dorëzohet edhe prezentimi audio-vizual 3D, me maximum 2.5 minuta kohëzgjatje.

*Vërejtje: Të gjitha materialet e lartëcekura duhet të dorëzohen edhe nëformë digjitale, në CD apo USB disk;

- Dokumentacioni shtesë
Punimet fituese janë të detyruara të paraqesin dokumentacion shtesë tëprojektit, në rast të ndonjë kërkesë nga ana e investitorit.

5. KRITERET VLERËSUESE

Të gjitha projektet ideore që do të konkurojnë në këtë konkurs do të vlerësohen nga juria profesionale, e themeluar nga Komiteti drejtues i këtij projekti. Do të shpallen tre fitues.

Çmimet do të ndahen si në vijim:

Çmimi i parë do të shpërblehet me kontratën për hartimin e projektit zbatues me të gjitha fazat.

Çmimi i dytë do të shpërblehet me 60 000 euro

Çmimi i tretë do të shpërblehet me 40 000 euro

- Vlerat e cekura per shpërblime janë te parapara me te gjitha taksat dhe tatimet e parapara me ligj ne Kosovë.
- Ndersa nese Operatoret Ekonomik te shpërblyer me çmimin te I_re , tell_te, apo te III_te ndonjëri prej tyre eshte operator ndërkombëtar nga vlera e pagesës se parapara do ti zbritet TVSH-ja.

VLERËSIMET E PROJEKTEVE DO TË BËHEN DUKE VLERËSUAR KËTO KRITERE:

1. Kriteri hapësinor (20 pikë), përfshinë:

- Raporti në mes të pjesëve dhe tërësisë hapësinore.
- Kualiteti i hapësirës
- Harmonizimi mjedisor/urban

2. KRITERI PROGRAMOR (20 PIKË), PËRFSHINË:

- Funkcionaliteti dhe arsyeshmëria funksionale e zgjidhjes.
- Shfrytëzimi racional i hapësirës.
- Respektimi dhe përmbushja e detyrës projektuese dhe programit hapësinor.

3. KRITERI EKONOMIK (20 PIKË), PËRFSHINË:

- Aspekti ekonomik i zgjidhjes së projektuar.
- Racionaliteti i zgjidhjes.
- Mirëmbajtja dhe shpenzimet e saj, bazuar në karakterin e kompleksit.

4. KRITERI ESTETIK (30 PIKË)

- Originaliteti i zgjidhjes.
- Inovacioni dhe vlera estetike.

- Zgjidhja konsekuente e tërësisë
- Vlerat arkitektonike
- Qasja bashkohore e integritit të vlerave burimore të ndërtesave ekzistuesetë
Tulltores në projekt-konceptin e propozuar.

5. KRITERI EKOLOGJIK (10 PIKË), PËRFSHINË:

- Ruajtja dhe avansimi ekologjik.
- Eficienca energjetike.
- Përdorimi i materialeve ekologjike.

RESPEKTIMI I AFATIT KOHOR

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit kohor nuk do të vlerësohet nga juria. Në rast të dërgimit të materialit ofertues me postë, si datë e pranimit do të merret data dhe ora e mbërritjes në adresën e precizuar në këtë dosje të prokurimit dhe jo data dhe ora e dorëzimit në postë apo cilindo institucion tjetër.

6. VLERËSIMET

Vlerësimi i projekt-propozimeve bëhet nga juria përkatëse profesionale.

Juria do të bëjë një vlerësim preliminar, i cili do të vlerësojë punimet për nga ana e kriterëve të përshtatshmërisë, i cili do të filtrojë elaboratet që nuk i përmbushin kushtet minimale të parapara me konkurs.


Juria do të vlerësojë Koncept Projektet në bazë të përgjegjshmërisë së tyre, sipas kërkesave teknike dhe/ose estetike, duke aplikuar kriteret e vlerësimit, nën-kriteret, dhe sistemit të pikëve të caktuara nga kjo juri. Një Projekt do të refuzohet nëse nuk i përgjigjet aspekteve të rëndësishme të dosjes së konkursit të projektimit, dhe në veçanti kërkesat teknike dhe/ose estetike.


Poentimi do të jete me max 100 pikë, ndërsa pragu për të marrur njërin nga çmimet, 70 pikë.


Pjesa e II-te përshkrimi i çmimit

Konkurs projektimi - Art&teknology Hub - Tulltorja.

Nr.	Pershkrimi i artikullit	çmimi total me TVSH
1.	- Konkurs projektimi - Art&teknology Hub - Tulltorja.	1,200,000 euro

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	ORG URBANISM & ARCHITECTURE BV
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	NATALIE SEYS
NËNSHKRIMI:	
DATA:	27.10.2023
VULA:	

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	RAFI SEGAL ARCHITECTURE URBANISM LLC
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	RAFI SEGAL
NËNSHKRIMI:	
DATA:	27.10.2023
VULA:	

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	OULD+ARCHITECTS SHPK
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	BEKIM RAMKÛ
NËNSHKRIMI:	
DATA:	27.10.2023
VULA:	